

Gjykata Supreme e Kosovës
Ap.-Kž. Nr. 1/2009
7 tetor 2009

Në emër të popullit

Gjykata Supreme e Kosovës në kolegjin e përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it, Norbert Koster si Kryetar i kolegjit, dhe gjyqtarët tjerë të EULEX-it Guy van Craen, Emilio Gatti, Ferdinando Buatier de Mongeot dhe Angela Kaptein si anëtarë të kolegjit, të ndihmuar nga procesmbajtësja Valentina Gashi,

Në lëndën penale kundër të akuzuarit Miroslav Vuckovic, me pseudonimin 'Mosa', emri i të atit Momcilo Vuckovic, mbiemri i vajzërisë së të ëmës Borka Jevtić, i lindur më 22 shtator 1948 në fshatin Gornji Suvi Do, serb i Kosovës nga komuna e Mitrovicës, i ve, baba i dy djemve, di shkrim-lexim, nuk dihet nëse është i punësuar apo jo, ka të kryer shkollën e lartë teknike, ka të kryer shërbimin ushtarak në Kovin në vitin 1967, nuk dihet gjendja e tij ekonomike dhe nuk ka qenë i dënuar më herët,


I akuzuar me pesë (5) pika të aktakuzës për Krime të luftës, të përcaktuara me Nenin 142, lidhur me Nenet 22 dhe 26 të Ligjit penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (LP të RSFJ-së),

Duke vendosur rreth ankesave të avokatëve mbrojtës dhe të akuzuarit kundër aktgjykimit të dorëzuar nga Gjykata e Qarkut të Mitrovicës, më 23 maj 2008 (P. Nr. 48/01), përkatësisht njëres ankesë të paraqitur nga avokati Milan Vujin nga Beogradi, më 3 nëntor 2008, një nga avokati mbrojtës Miro Delevic nga Zveçani më 3 nëntor 2008, një nga avokati Bogdan Vladislavljevic nga Mitrovica më 4 tetor 2008 dhe një nga vetë i akuzuari më 10 nëntor 2008,

Pas shqyrtimit të ankesave në seancën e mbajtur më 9 qershor 2009, dhe pas këshillimit dhe votimit të mbajtur më 9 qershor, më 14 shtator dhe më 7 tetor 2009, sjell këtë:

Aktgjykim

Pranohen ankesat e paraqitura nga i akuzuari dhe në emër të tij kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës, më datën 23 maj 2008 (P. 48/01). **Ndryshohet** Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe i akuzuari **lirohet** nga të gjitha akuzat.



Arsyetim:

I. Historia procedurale

Ankesat para Gjykatës Supreme kanë të bëjnë me aktgjykimin që është sjellë pas rigjyimit të dytë të së njëjtës çështje.

1. Gjykimi i parë para Gjykatës së Qarkut


Gjykimi i parë është mbajtur para trupit gjykues të Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës, të përbërë nga gjyqtari vendor profesional si kryetar i trupit gjykues, një gjyqtar ndërkombëtar si dhe tre gjyqtarë porotë. Ky trup gjykues më datën 18 janar 2001 ka shpallur fajtor akuzuarin për veprën penale të Gjenocidit në bashkëpunim, sipas nenit 141, lidhur me nenin 22 të LP të RSFJ-së dhe e ka dënuar të njëjtin me 14 (katërbëdhjetë) vjet burgim.

2. Vendimi i parë i Gjykatës Supreme të Kosovës

Prokurori ka paraqitur ankesë duke kërkuar shqiptim të dënimit më të ashpër me burg. Avokatët mbrojtës si dhe vetë i pandehuri kanë paraqitur ankesa kundër aktgjyimit duke pohuar shkelje esenciale të ligjit mbi procedurën penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të kodit penal dhe duke pohuar se dënimi ka qenë në mënyrë jo-proporcionale i ashpër.

Ankuesit kanë kërkuar shfajësim nga të gjitha akuzat ose anulim të aktgjyimit së bashku me urdhërimin e rigjyimit të lëndës. Prokurori publik i Kosovës në mendimin e tij të datës 30 gusht 2001 ka propozuar miratimin e ankesave të avokatit mbrojtës dhe prapësimin e lëndës për rigjykim në gjykatën e shkallë së parë.

Në seancën e kolegjit të mbajtur më 31 gusht 2001, Gjykata Supreme e Kosovës ka shqyrtuar shkresat e lëndës dhe ka ekzaminuar aktgjykimin e kundërshtuar në përputhje me nenin 385 të Ligjit mbi Procedurën Penale (LPP). Ajo ka konstatuar se gjykata e shkallës së parë ka shkelur ligjin penal duke e dënuar të akuzuarin për vepër penale të gjenocidit pa provuar qëllimin e të akuzuarit për ta shkatërruar një grup etnik në tërësi apo pjesërisht, siç kërkohet me rastin e provimit të elementit subjektiv të krimit.



Kolegji i Gjykatës Supreme më tej ka konstatuar se veprat penale të pohuara nuk përmbajnë elementet e krimit të gjenocidit, por të njëjtat është dashur të cilësohen si Krime lufte sipas nenit 142 të LP të RSFJ-së. Përveç kësaj, kolegji i Gjykatës Supreme ka konstatuar shkelje esenciale të ligjit mbi procedurën penale, përkitazi me vërtetimin e gjendjes faktike, për shkak të faktit se besueshmëria e disa dëshmitarëve nuk është vlerësuar sa duhet, ndërsa disa dëshmitarë të propozuar nga mbrojtja nuk janë dëgjuar.

Për këtë arsye, Gjykata Supreme ka pranuar ankesat e paraqitura nga mbrojtja dhe ka anuluar aktgjykimin. Ankesa e prokurorisë është refuzuar si a palejueshme.

3. Gjykimi i dytë para Gjykatës së Qarkut

Rigjykimi është mbajtur para trupit gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë profesionalë, dy nga të cilët ishin gjyqtarë ndërkombëtarë. Pas dyzet e katër (44) seanceve, kjo gjykatë shpalli aktgjykimin e saj më 25 tetor 2002, përmes të cilit i akuzuari u shpall fajtor për kryerjen e veprës penale të Krimeve të luftës kundër popullsisë civile, në bashkëpunim me të tjerët, në përputhje me nenin 142, paragrafin 1 të LP të RSFJ-së, lidhur me nenin 22 të LP të RSFJ-së për këto vepra penale:


- a. Shkatërrim i paligjshëm dhe i qëllimshëm i pasurisë, sipas nenit 142, lidhur me nenin 22 të LP të RSFJ-së dhe të përfshirë në nenin 147 të Konventës së katërt të Gjenevës të vitit 1949 (shkelje e rëndë);
- b. Vjedhje e pasurisë në shkallë të gjerë, sipas nenit 142 të LP të RSFJ-së, lidhur me nenin 22 të LP të RSFJ-së dhe të përfshirë në nenin 4, paragrafin 2 (g) të Protokollit shtesë II (1977) të Konventës së Gjenevës të vitit 1949;
- c. Zbatim i masave të frikësimit dhe të terrorit dhe rrezikim i sigurisë së personave të tjerë, sipas nenit 142 të LP të RSFJ-së, lidhur me nenin 22 të LP të RSFJ-së dhe të përfshirë në nenin 1 (a) të nenit të përbashkët 3 të Konventës së Gjenevës të vitit 1949, neni 4, paragrafi 2 (a) i Protokollit shtesë II (1977) të Konventës së Gjenevës të vitit 1949.

Gjykata e shkallës së parë ka dënuar të akuzuarin me dymbëdhjetë (12) vjet burgim.

4. Vendimi i dytë i Gjykatës Supreme

Ankesat kundër këtij aktgjykimi të shkallës së dytë janë paraqitur nga avokatët mbrojtës dhe nga i akuzuari.

Mbrojtja ka pohuar shumë shkelje të ligjit procedural dhe të atij material.



Çështja kryesore e ngritur nga mbrojtja ka qenë vlerësimi i gjykimit të besueshmërisë së dëshmitarëve të prokurorisë. Mbrojtja ka pohuar se gjykata ka gabuar në cilësimin e arsyeve të mospërputhjeve dhe kundërshtive të konstatuara në deklaratat e dëshmitarëve të ndryshëm, dhe në mes të deklaratave të dhëna nga dëshmitarë të njëjtë gjatë fazave të ndryshme të procedurës, deri tek faktorët psikologjikë, siç është stresi, frika dhe trauma dhe niveli i ndryshëm i saktësisë gjatë mbajtjes së procesverbalit në shqyrtimet e tyre. Mbrojtja ka pohuar se këto mospërputhje në deklaratat e dëshmitarëve ka rezultuar nga fakti se ata kanë vepruar në bazë të modelit të rrënjosur të motivuar nga padurimi etnik.

Në këtë mënyrë, mbrojtja ka kundërshtuar besueshmërinë e dëshmitarëve të prokurorisë përkitazi me kundërshtitë dhe mospërputhjet e shumta të cilat pohohet se janë konstatuar në deklaratat e tyre.


Përveç kësaj, është argumentuar se Gjykata e Qarkut ka konstatuar fajësinë e të akuzuarit si rezultat i paragjykitimit ndaj tij, duke shkëlur kështu nenin 6 të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut (KEDNj), nenin 364, paragrafin 2 të LPP-së dhe parimin e supozimit të pafajësisë (neni 3 i LPP-së). Mbrojtja ka pohuar se gjykata e shkallës së parë ka treguar anësi ngase ka zbatuar standard të dyfishtë gjatë vlerësimit të besueshmërisë së dëshmitarëve duke theksuar kundërshtitë ndërmjet deklaratave të të akuzuarit dhe të dëshmitarëve të mbrojtjes kur ka minimizuar kundërshtitë e deklaratave të dhëna nga dëshmitarët e prokurorisë.

Për më tepër, ankuesit kanë kundërshtuar konstatimin e nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë se i akuzuari ka kryer veprat penale së bashku dhe në emër të forcave të armatosura jugosllave, një element ky që ka qenë vendimtar që veprat penale të cilësohen si krim lufte në vend të cilësimit si vepër e zakonshme penale.

Ankuesit kanë theksuar se edhe sipas ligjit të zbatueshëm ndërkombëtar dhe sipas atij vendor, kryerësi i veprës penale të krimeve të luftës duhet patjetër të jetë ose anëtar i ndonjë organizate ushtarake, politike apo administrative që merr pjesë në konflikt ose person që është në shërbimin e tyre, apo ndryshe që krimin ta kryejë në emër të forcave të armatosura (organizatave ushtarake, politike apo administrative që marrin pjesë në konflikt).

Mbrojtja ka argumentuar se dëshmitë rrethore të paraqitura nga dëshmitarët e prokurorisë për mbështetjen e qëndrimit se i akuzuari ka kryer krimet si anëtar i forcave të armatosura ose në emrin e tyre nuk ka mundur të përjashtojë plotësisht një interpretim dhe përfundim tjetër.

Në fund, mbrojtja ka pohuar se faktet janë vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë, pasi që gjykata e shkallës së parë nuk ka arritur të provojë përtej çdo dyshimi se i akuzuari ka qenë ose epror komandues që ka dhënë urdhra për kryerjen e krimeve të luftës, ose anëtar i një strukture të organizuar ushtarake ose politike si palë në konfliktin e armatosur, ose person në shërbimin e tyre.



Mbrojtja për më tepër ka pohuar shkelje të shumta të procedurës penale. Mbrojtja po ashtu argumentuar se aktgjykimi nuk ka arritur ta vlerësojë çdo dëshmi, duke ofruar në veçanti një vlerësim të besueshmërisë së dëshmive kundërthënëse.

Në këtë kuptim, mbrojtja ka pretenduar se gjykata e shkallës së parë ka shkelur detyrimin e saj për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë besnike (neni 15, paragrafi 1 dhe 2 i LPP-së) dhe për vlerësimin e dëshmive individuale dhe të atyre të lidhura me njëra tjetrën (neni 347, paragrafi 2 i LPP-së), kur e ka bazuar aktgjykimin e saj në pjesë të dëshmive të disa nga dëshmitarët dhe jo në dëshmitë e tyre të plota.

Sa u përket shkeljeve të ligjit penal, mbrojtja ka pretenduar se dëbimi me dhunë i civilëve nuk është i përfshirë në përkufizimin e veprës Krime lufte, sipas nenit 142 të LP të RSFJ-së. Mbrojtja ka argumentuar se neni i përbashkët 3 i Konventës së Gjenevës nuk e ndalon në mënyrë eksplicite dëbimin e popullsisë civile.

Edhe pse e drejta sipas praktikave të mëparshme të Gjykatave ndërkombëtare *Ad Hoc* ka përcaktuar rastet kur dëbimi i dhunshëm i civilëve cilësohet si krim lufte, kjo jurisprudencë nuk ka mundur të zbatohet në Kosovës në bazë të parimit të barazisë dhe të zbatimit të ligjit më të favorshëm penal, të paraparë me nenin 4 të LP të RSFJ-së.

Përveç kësaj, mbrojtja ka theksuar se ligji ndërkombëtar humanitar që zbatohet në konfliktet e armatosura ndërkombëtare mbron pasuritë e popullsisë civile vetëm në rastet e okupimit nga një subjekt i huaj. Pasi që Kosova ishte ende pjesë përbërëse e territorit sovran të RFJ-së, situata në konfliktin e armatosur në Kosovë nuk ka mundur të cilësohet si okupim. Rrjedhimisht, grabitja dhe shkatërrimi i pasurive të shqiptarëve të Kosovës nuk përbënte veprë penale të krimeve të luftës, në bazë të nenit 142 të LP të RSFJ-së.

Mbrojtja ka vënë në dyshim arsyetimin e gjykatës, në të cilin gjykata i referohet jurisprudencës së GjPNJ-së, përkatësisht aktgjykimin në rastin *Celebici*, në të cilin GjPNJ-ja ka konsideruar Konventat e cituara të Gjenevës aq të rëndësishme saqë ato janë konsideruar të vlefshme si në konfliktet e armatosura ndërkombëtare ashtu edhe në ato të brendshme.

Sipas pikëpamjes së mbrojtjes, e drejta e GjPNJ-së në rastin *Celebici* i është referuar gjendjes së okupimit, që nuk ka qenë rasti edhe në konfliktin e armatosur në Kosovë. Pikëpamja e mbrojtjes ka qenë se zbatimi i nenit të përbashkët të Konventave të Gjenevës ka qenë legjitim vetëm në këtë rast, dhe se ky nen nuk i referohet pasurisë së mbrojtur, por vetëm personave të mbrojtur.

Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykimin e lëshuar më 15 korrik 2004 ka konstatuar se dënimin ndaj të akuzuarit përsëri është mbështetur në një vlerësim të pasaktë dhe jo të plotë të dëshmive dhe në konstatim pa dyshim të pasaktë të fakteve (neni 366 i LPP-së). Për të arritur tek një konstatim i këtillë, Gjykata Supreme e Kosovës ka marrë parasysh mospërputhjet e shumta të gjetura në dëshmitë fajësuese mbi të cilat është mbështetur trupi gjykues, të cilat kanë minuar bazën e përgjithshme faktike të akuzave.

Rrjedhimisht, Gjykata Supreme përsëri ka vendosur që ta prishë aktgjykimin dhe ta kthejë lëndën për rigjykim, në bazë të nenit 385, paragrafit 1 të LPP-së. Me qëllim të ofrimit të udhëzimeve për rigjykim, Gjykata Supreme ka adresuar qëllimisht pikat e përzgjedhura të ligjit, të cilat janë konsideruar të jenë të rëndësishme për procedurën e mëtejme.

Në këtë drejtim, duhet të përmendet aktgjykimi i Gjykatës Supreme i datës 15 korrik 2004, në disa pjesë të të cilit shkruan si vijon:


“Gjykata Supreme pajtohet me Gjykatën e Qarkut se prania e kundërthënies dhe mospërputhjeve nuk përjashton në mënyrë automatike dhe *a limine* dëshminë e dëshmitarit. Në përgjithësi, gjykata nuk duhet të trajtojë mospërputhjet e vogla ndërmjet dëshmisë së dëshmitarëve të ndryshëm, ose ndërmjet dëshmive të një dëshmitari të caktuar dhe një deklarate të mëhershme të dhënë nga ai dëshmitar, si diskreditim i dëshmive të tyre si tërësi kur ai dëshmitar megjithatë ka treguar në hollësi esencën e këtij incidenti të ngarkuar. Megjithatë, kjo qasje duhet të ndryshojë në varësi nga cilësia e dëshmisë së atij dëshmitari në raport me esencën e incidentit të ngarkuar.

Gjykata Supreme thekson se në çdo shkallë, gjykata duhet ta shqyrtojë natyrën e kundërthënies nëse ato kanë të bëjnë me elementet faktike përmbajtësore apo sekondare, nëse ato mund të shpjegohen apo jo, dhe nëse në frymën e rrethanave të përgjithshme, ato tregojnë pavërtetësinë e dëshmitarit.

Pavarësisht nëse nga kundërshtitë dhe mospërputhjet janë të justifikueshme apo jo, nëse kanë të bëjnë me elementet përbërëse të veprës penale, ato duhet patjetër të shpjegohen në atë masë saqë në fund këto dëshmi të mos lënë asnjë pikë dyshimi për praninë e këtyre elementeve. Përndryshe, në pajtim me supozimin e pafajësisë, gjykata duhet patjetër të veprojë *in dubio pro reo*.

Kur çështja kryesore për përcaktimin e përgjegjësisë është identifikimi i të akuzuarit në rastin penal, kundërthëniet që kanë të bëjnë me elementet faktike siç janë kriteret që lidhen me njohjen e të akuzuarit në radhët e kryerësve të tjerë, veprimet specifike që i janë veshur të akuzuarit dhe siguria e deklaratës për kohën dhe vendin e këtyre veprimeve në kundërshtim me alibinë e të akuzuarit nuk guxon aq lehtë të përjashtohet.

Gjykata Supreme po ashtu pajtohet me Gjykatën e Qarkut se mospërputhjet dhe kundërshtitë në dëshmitë e dëshmitarit mund të jenë rezultat i tekeve të natyrshme të perceptimit njerëzor, sidomos në ata dëshmitarë që u janë nënshtruar ndodhjeve traumatike dhe të cilët për shkak të rrethanave procedurale është dashur të japin deklaratat e tyre për të njëjtën ngjarje në disa raste.



Megjithatë, duke pranuar se me kalimin e kohës, njerëzit natyrisht i harrojnë faktet, dhe se gjendja e zemërimit serioz pengon perceptimin dhe mbajtjen në mend të fakteve, gjykata në masë të arsyeshme pret pasaktësi, shtrembërim të rendit të ngjarjeve dhe ngatërrim me elementet e ndodhive të tjera.

Një fenomen i kundërt me këtë – përmirësim të dëshmisë, ofrim të hollësive të tjera me kalimin e procedurës, kërkon sqarim specifik. Në veçanti, gjykata duhet të zbatojë një shqyrtim të kujdesshëm dhe të hollësishëm në ato raste kur në deklaratën e dëshmitarit hetohet një strukturë në rritje e fajësimit, përfshirë rastet kur pranimi i të akuzuarit apo veshja e kryerjes së veprimit specifik penal bëhet gjatë dhënies së dëshmisë në shqyrtimet në vazhdim.

Për më tepër, Gjykata Supreme çmon rëndësinë e të dhënave të hollësishme dhe të besueshme hetimore të gjykatës për gjetjen e fakteve. Vërtet, ky është shpjegimi i arsyeshëm i cili qëndron pas dispozitës se akuzat serioze, si rregull, duhet të paraprihen nga një hetim – neni 161 i LPP-së.


Në përputhje me nevojat e zhvillimit të hetimit në rastet serioze dhe komplekse, ekzistojnë disa garanci për procedurën e zhvillimit të veprimeve hetimore, të përcaktuara që të sigurojnë saktësinë e tyre, siç janë: hetimi të kryhet nga një gjyqtar, dëshmia e rreme të sanksionohet, palët të kenë të drejtën të jenë të pranishme dhe t'u përgjigjen pyetjeve, të kenë qasje në të dhënat dhe të kenë të drejtën të kërkojnë korigjime dhe pas bërjes së tyre këto të dhëna të lexohen dhe të nënshkruhen nga dëshmitari.

Rrjedhimisht, sa herë që organet për zbatimin e drejtësisë kanë debatuar në mes vete lidhur me përmbajtjen dhe formën e të dhënave hetimore, mospërputhjet përmbajtjesore që kanë ndodhur më vonë ndërmjet dëshmimeve të fazës hetimore dhe të atyre të gjykimit nuk duhet të injorohen automatikisht dhe në mënyrë kolektive me qëllim që të kenë efekt favorizues për prokurorinë.

Në vend të kësaj, në pajtim me supozimin e pafajësisë dhe ngarkesën e provave që dalin nga kjo, është detyrë e gjykatës që në mënyrë të sigurt të eliminojë mundësinë që këto mospërputhje kanë ndodhur pavarësisht nga sinqeriteti dhe besueshmëria e dëshmitarëve.

Rregulla e njëjtë duhet të zbatohet madje edhe në mënyrë më rigoroze gjatë rigjyimit në raport me dëshminë e nxjerrë në gjykimin e parë. Pranimi i qasjes së kundërt, do të thotë mospërfillja e mospërputhjeve dhe kundërthënieve që përsëriten në dëshmitë e mëhershme derisa dëshmitarët të gjejnë dëshminë e qëndrueshme fajësuese do të demaskonte arsyetimin e vlerësimit të dëshmimeve dhe supozimin e pafajësisë.

Përfundimisht, Gjykata Supreme pajtohet se besueshmëria e dëshmitarëve, përfshirë çfarëdo motivi që ata mund të kenë për të dhënë dëshmi të rreme, është vërtetimi që



duhet bërë në rastin e secilit dëshmitarë individualisht. Nuk do të ishte as e përshtatshme e as korrekte të përfundohet se një dëshmitar konsiderohet qenësisht i pabesueshëm vetëm se ai apo ajo është anëtar i grupit etnik të veçantë, e as nëse viktimat e krimit të kryer nga personat e të njëjtit grup etnik si i akuzuari. Për të mos thënë se urrejtja etnike kurrë nuk mund të jetë bazë për dyshim në besueshmërinë e cilitdo dëshmitarë të veçantë. Vërtetimi i tillë mund të bëhet në dritën e rrethanave të secilit dëshmitarë individualisht, përfshirja e tij apo saj në ngjarje dhe interesi në procedurë dhe brengat e tilla mund të vërtetohen me dëshmi. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata Supreme konstaton se Gjykata e Qarkut ka dështuar të arsyetoj sa duhet refuzimin e pretendimit të mbrojtjes lidhur me fabrikimin e akuzave, posaçërisht në dritën e rrethanave në vijim:

- Se të gjithë dëshmitarët gjatë konfliktit kanë qenë drejtpërdrejt të lënduar nga veprimet e forcave Serbe, për më shumë, ata ngritin pretendime për kompensim. I akuzuari ka pronë në atë zonë. Prandaj, dëshmitarët mund të jenë personalisht të motivuar që ta inkriminojnë të akuzuarin;
- Se dëshmia e pesë [5] dëshmitarëve të prokurorisë të cilët kanë implikuar drejtpërdrejt të akuzuarin në krime serioze ka qenë tërësisht e diskredituar nga gjykata dhe që pa identifikim nga ana e tyre cilido motiv individual për fajësim të rremë të të akuzuarit – prandaj duke treguar mundësinë e konspiracionit;
- Se shumica e dëshmitarëve në dëshmitë e të cilëve është mbështetur gjykata për dënim kanë qenë fqinj dhe kanë qenë në marrëdhënie familjare me njëri tjetrin [në parim, përveç Abedin Jasharit, ata janë të dy familjeve: Beka dhe Sahiti] dhe se dëshmitarët dëshmitë e të cilëve janë diskredituar nga gjykata, përveç njërit, kanë qenë gjithashtu të Sahitëve. Dëshmitarët të cilët janë gjetur si të pabesueshëm kanë dëshmuar, në konfiguracione të ndryshme, sa i përket këtyre ngjarjeve pasi që dëshmitarët të cilët kanë qenë të besueshëm, implikimi i të akuzuarit dhe atestimi i pranisë së njëri tjetrit në vendin e krimeve të pohuara.
- Se ka pasur dëshmitarë tjerë të cilët e kanë implikuar të akuzuarin, nga të cilat Prokuroria ka hequr dorë, si duket për shkak të mungesës së besueshmërisë, pasi që të dhënat nga dëgjimet e mëparshme reflektojnë kundërtënie të mëdha në dëshmitë e tyre;
- Se dëshmitari i Prokurorisë në të cilin është mbështetur gjykata në mënyrë që ta dënoj të akuzuarin nga e njëjta gjykatë është konstatuar të jetë i pabesueshëm në veshjen e pozitës udhëheqëse të akuzuarit. Ky element tregon se dëshmitarët kanë qenë të prirë për fajësimin e të akuzuarit përtej njohurive dhe përvojës së tyre.
- Në mendimin e Gjykatës Supreme rrethanat e lartpërmendura bëjnë thirrje për një vlerësim të përgjithshëm të dëshmive të dëshmitarëve në aspektin e konspiracionit të mundshëm si plotësim i vlerësimit të tyre në mënyrë të detajuar për aspektin e mospërputhjes së brendshme.


- Për më shumë, Gjykata Supreme ka shqyrtuar me kujdes dokumentet në dosje në mënyrë që të verifikoj nëse gjykata e shkallës së parë ka përcaktuar në mënyrë korrekte mospërputhjet dhe kundërthëniet në deklaratat e këtyre dëshmitarëve në të cilat është mbështetur gjykata dhe se a kanë qenë në të vërtetë jo-relevante dhe të arsyetueshme nga rrethanat.

...

Gjykata Supreme nuk ka për qëllim ti shteroj të gjitha kundërthëniet në dëshminë në të cilën mbështetet gjykata. Ato të diskutuarat *supra* janë të mjaftueshme për të vënë në pikëpyetje qasjen të cilën gjykata i ka atribuuar atyre në mënyrë kolektive për mungesën e saktësisë gjatë hetimeve dhe faktorin e stresit gjatë ngjarjeve traumatike. Si pasojë, saktësia e të gjeturave të gjykatës janë të minuara.

Gjykata Supreme shpreson se gjatë rigjyqimit Gjykata e Qarkut do ta rivlerësoj dëshminë e dëshmitarit. Rivlerësimi duhet të bëhet për secilin dëshmitarë individualisht dhe duhet të përfshijë faktorët si: besueshmëria e identifikimit të të akuzuarit, kur është e aplikueshme, duke marrë parasysh gjendjen fizike në të cilën i akuzuari pohon ta ketë njohur të akuzuarin; përputhshmëria e brendshme e dëshmisë, përfshirë arsyeshmërinë e dallimeve në mes të versioneve të ndryshme të ngjarjes së njëjtë; përputhshmëria me dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë; duke përfshirë indikacionet se në dëshminë e kujt gjykata ka zgjedhur të mbështetet në rastet kur ka shpjegime të ndryshme për ngjarjen e njëjtë apo në deklaratën që dëshmitë nuk kanë qenë jovendimtare. Në vlerësimin e besueshmërisë së dëshmitarëve Gjykata e Qarkut duhet të ketë parasysh faktorët e përgjithshëm që mund të kenë lidhje me besueshmërinë (e identifikuar *supra* në faqen 13 të këtij mendimi) dhe duhet në mënyrë specifike ti diskutoj në aspektin e pretendimeve të Mbrojtjes lidhur me konspiracionin në mesin e dëshmitarëve.

Në rast se Gjykata i gjen të dëshmuara disa apo të gjitha aktet specifike të pohuara në aktakuzë, duhet të vlerësoj se a e mbështesin dëshmitë praninë e elementeve vendimtare për tezën që i akuzuari ka vepruar në emër të, dhe në marrëveshje me forcat Jugosllave.”



5. Gjykimi i tretë pranë Gjykatës së Qarkut

Rigjykimi i dytë është mbajtur pranë trupit gjykues të përbërë nga tre (3) Gjyqtarë ndërkombëtar në mes të 16 gushtit 2007 dhe 22 majit 2008.

Gjykata e shkallës së parë përsëri ka dëgjuar dëshmitarë të shumtë, në fund duke besuar në kredibilitetin e vetëm dy dëshmitarëve të prokurorisë, Gani Bekës dhe Selman Avdiut. Dëshmitë e jo më pak se njëzetetë (23) dëshmitarëve të tjerë të prokurorisë janë kualifikuar si qoftë jo-relevante apo jo të besueshme. Alibi i ngritur nga i akuzuari është hedhur poshtë nga gjykata e shkallës së parë edhe pse ka qenë e konfirmuar jo vetëm nga disa dëshmitarë.

Me aktgjykimin e datës 23 maj 2008, gjykata e shkallës së parë ka shpallur të akuzuarin fajtor për

Plaçkitje, sipas nenit 142, lidhur me nenet 22 dhe 26 të Kodit Penal të Jugosllavisë (KPJ-së), dhe i përfshirë nga neni 4, paragrafi 2 (g) i Protokollit II Shtesë e Konventës së Gjenevës të vitit 1949

dhe

aplikimi i Masave të kërcënimit dhe terrorit, sipas nenit 142, lidhur me nenet 22 dhe 26 të Kodit Penal të Jugosllavisë (KPJ-së), dhe i përfshirë nga neni 13, paragrafi 2 i Protokollit II Shtesë i Konventës së Gjenevës të vitit 1949

Sa i përket tri (3) pikave të mbetura të aktakuzës, i akuzuari nuk është shpallur fajtor dhe është liruar nga këto akuza.

Trupi gjykues i ka shqiptuar të akuzuarit dënime prej pesë (5) dhe shtatë (7) viteve burgim, e cila ka rezultuar në një dënim të total prej tetë (8) viteve burgim.

Aktgjykimi është ankimuar nga avokatët mbrojtës - Miro Delevic, Bogdan Vladisavljevic, Milan Vujin - dhe nga vetë i akuzuari.

6. Çështjet e ngritura në ankesa

Argumentet në ankesa janë kryesisht të ngjashme me parashtresat e ankesave të mëparshme dhe prandaj do të përmbliidhen vetëm shkurtimisht.

a.

Avokati mbrojtës Miro Delevic në ankesën e tij të datës 3 nëntor 2008 pretendon:




1. se aktgjykimi është i paqartë dhe pakuptueshëm në dispozitiv dhe në arsyetim. Aktgjykimi është gjithashtu i paqartë sa i përket kualifikimit ligjor të veprës dhe zbatimit të ligjit material;
2. se konflikti në mes të UÇK-së dhe forcave të armatosura Serbe nuk mund të karakterizohet si konflikt i armatosur ndërkombëtar dhe se i akuzuari ka qenë civil dhe si pasojë ai nuk ka mundur të kryej krime të luftës ;
3. se paaftësia fizike e të akuzuarit në kohën kur janë kryer krimet e pretenduara nuk është marrë parasysh dhe se Gjykata e Qarkut ka dështuar në ekzaminimin e problemeve shëndetësore të ngritura nga i akuzuari.

b.

Avokati Bogdan Vladisavljevic në ankesën e tij të datës 4 tetor 2008 pretendon:

1. se aktgjykimi i shpallur më 23 maj 2008 nuk është identik me aktgjykimin me shkrim. Mospërputhjet janë të një rëndësie primare, për shembull kur aktgjykimi i shpallur thotë se i akuzuari “ka hyrë me dhunë” në objekt, kurse aktgjykimi me shkrim përdorë fjalët “duke thyer me forcë”, apo kur aktgjykimi i shpallur thotë se i akuzuari ka “e ka hequr nga i fundit”, kurse aktgjykimi me shkrim përdor fjalët “e ma marrë nga atje”;
2. se dispozitivi është i paqartë pasi që nuk i referohet dispozitave të veçanta që specifikojnë veprën penale për të cilën i akuzuari është dënuar për të dy pikat e dispozitivit;
3. se dispozitivit gjithashtu i mungojnë motivet;
4. se dispozitivi nuk i referohet dispozitave që janë përdorur si bazë për sanksionimin e të akuzuarit dhe gjithashtu nuk e paraqet mënyrën në të cilën është dhënë dënimi për të gjitha veprat në bashkim;
5. se aktgjykimi ka tejkalar aktakuzën duke thënë se terrori i përhapur në përmasa të gjera ka qenë i drejtuar kundër tërë komunitetit etnik edhe pse aktakuza e ka identifikuar popullatën civile si objekt i mbrojtur;
6. se gjykata ka dështuar të identifikoj bashkëkryerësit dhe të vërtetoj qëllimin e përbashkët;
7. se dëshmitarët Gani Beka dhe Selman Avdiu nuk janë të besueshëm;



8. se gjykata ka injoruar alibinë e të akuzuarit dhe ka dështuar të vlerësoj dhe të merr parasysh në mënyrë të duhur gjendjen specifike shëndetësore të të akuzuarit në kohën kur kanë ndodhur krimet.

c.

Avokati mbrojtës Milan Vujin në ankesën e tij të datës 3 nëntor 2008 pretendon:


1. se aktakuza është ndryshuar shumë herë, herën e fundit më 6 maj 2008, në këtë mënyrë duke penguar mbrojtjen në përgatitjen e duhur;
2. se dispozitivi është i paqartë, kundërthënës me vetveten dhe se arsyetimi nuk ofron sqarime lidhur me faktet esenciale. Në veçanti vlera e mallrave, gjoja të marra nga i akuzuari, asnjëherë nuk është vërtetuar edhe pse plaçkitja i referohet pronës me vlerë të madhe;
3. se gjykata ka tejkalar aktakuzën në dënimin e të akuzuarit për krime të luftës të kryera më 15 prill 1999, edhe pse lidhur me këtë ditë i akuzuari është ngarkuar vetëm për shkak të rrezikut të përgjithshëm;
4. se dëshmitarët Gani Beka dhe Selman Avdiu nuk janë të besueshëm.

d.

I akuzuari në ankesën e tij të datës 10 nëntor 2008 pretendon:

1. se nuk mund ti besohet deklaratave të dëshmitarëve Gani Beka dhe Selman Avdiu;
2. se më 15 prill 1999 ai ishte në punë gjatë 24 orëve si vozitës i autoambulancës në spitalin e Mitrovicës;
3. se për shkak të lëndimit në këmbë ai është fizikisht i paafte në shkallë 80 për qind dhe prandaj ai nuk ka qenë në gjendje ti kryej krimet e pretenduara.

Prokurori i Shtetit i Kosovës në mendimin e datës 2 mars 2009, tregon se aktgjykimi nuk përmban asnjërin prej shkeljeve të ngritura në ankesa. Në veçanti Prokurori i Shtetit mendon se dispozitivi i aktgjykimit është i qartë, përmban arsye logjike është plotësisht i mbështetur me argumente bindëse në arsyetim. Për më tepër, gjykata e shkallës së parë i është përmbajtur plotësisht instruksioneve të dhëna nga Gjykata Supreme lidhur me vlerësimin e deklaratave të dëshmitarëve.



II. Gjetjet e Gjykatës Supreme

1.

Ankesat janë paraqitur me kohë dhe janë të lejueshme.

a.

Ligji i aplikueshëm në lëndën në fjalë është Ligji mbi Procedurën Penale (LPP), i cili ka qenë në fuqi si ligj procedural derisa Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës (KPPPK, tani Kodi i Procedurës Penale të Kosovës - KPPK) ka hyrë në fuqi më 6 prill 2004. Sipas nenit 550 të KPPK-së procedura penale në shkallën e parë, në të cilën është paraqitur aktakuza para datës së hyrjes në fuqi të KPPPK-së mirëpo e cila nuk është kompletuar deri me këtë datë do të vazhdohet sipas dispozitave të ligjit të mëparshëm të aplikueshëm deri në hedhjen poshtë në formë të prerë të procedurës penale me anë të Aktvendimit apo derisa aktgjykimi i lëshuar në shqyrtimin gjyqësor të bëhet i formës së prerë.


Aktakuza kundër të akuzuari është paraqitur shumë kohë para 6 prillit 2004. Pasi që neni 550 i KPPK-së i referohet kohës së “paraqitjes” së aktakuzës, është jo relevante që aktakuza gjatë procedurës është ndryshuar shumë herë edhe pas 6 prillit 2004. Prandaj procedura penale derisa aktgjykimi të bëhet i formës së prerë i përmbahet ligjit në fuqi para 6 prillit 2004, p.sh. LPP-së. Në pajtim me jurisprudencën e Gjykatës Supreme të Kosovës kjo gjithashtu vlen edhe për procedurat pranë gjykatës së shkallës së dytë apo tretë në mënyrë që ti shmangen konflikteve të pazgjidshme që do të dilnin si rezultat i aplikimit të ligjeve të ndryshme të procedurës në faza të ndryshme të shqyrtimit gjyqësor.

b.

Sipas nenit 359, paragrafit 1 të LPP-së ankesa duhet të paraqitet brenda 15 ditëve nga dorëzimi i aktgjykimit me shkrim.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë i është dorëzuar Avokatëve mbrojtës Miro Delevic dhe Bogdan Vladislavjevic më 21 tetor 2008. Pasi që aktgjykimi nuk ka mundur ti dorëzohet të akuzuarit, i cili ka ikur nga shteti para ditës së fundit të shqyrtimit gjyqësor, aktgjykimi është vendosur në tabelën e shpalljeve të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë më 29 tetor 2008 në pajtim me nenin 123, paragrafin 4 të LPP-së. Nuk është e qartë se kur i është dorëzuar aktgjykimi avokatit mbrojtës Milan Vujin. Fletë-dërgesa apo çfarëdo dëshmie tjetër nuk mund të gjendet në shkresat e lëndës.

Avokati mbrojtës Miro Delevic ka paraqitur ankesën e tij pranë Gjykatës së Qarkut më 5 nëntor 2008, brenda afatit prej 15 ditëve. E njëjta vlen edhe për ankesën e Avokatit



mbrojtës Bogdan Vladislavljevic¹, i cila e ka postuar ankesën më 5 nëntor 2008 në pajtim me nenin 90, paragrafin 3 të LPP-së, dhe ankesës të të akuzuarit e cila është paraqitur pranë Gjykatës së Qarkut më 11 nëntor 2008 brenda periudhës së 15 ditëve pas vendosjes së aktgjykimit në tabelën e shpalljeve të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë. Ankesa e paraqitur nga Avokati mbrojtës Milan Vujin duhet në çdo rast të pranohet si e paraqitur me kohë sepse nuk është e qartë se kur i është dërguar atij aktgjykimi me shkrim.

2.

Ankesat po ashtu janë të bazuara sipas Nenit 363 pika 3 dhe Nenit 366 Paragrafi 1 i LPP-së, sepse Gjykata e shkallës së parë prapë nuk ka vërtetuar drejtësisht gjendjen faktike.


a.

Gjykata Supreme e Kosovës në vendimin e vet të mëparshëm, të datës 15 korrik 2004, dha udhëzime të qarta – siç janë përshkruar më lart në detaje – sa i përket analizës së thukhtë të nevojshme me të cilat deklaratat e dëshmitarëve duhej të vlerësoheshin gjatë rigjykitimit të dytë. Gjykata Supreme dha një arsytim shterues për këtë mendim që është mbështetë plotësisht nga ana e këtij kolegji të Gjykatës Supreme.

Vështirësitë e veçanta lidhur me vlerësimin e deklaratave të dëshmitarëve në këtë lëndë dalin prej disa veçorive të shumta. Natyrisht vetë ngjarjet ia vështirësojnë shumë dëshmitarit të rikujtojë me një siguri të duhur incidentet e veçanta duke përfshirë identifikimin e njërit prej kryerësve dhe veprat specifike të kryera nga ky person.

Një fshat është grasatuar, dhe pastaj kanë hyrë grupe burrash të armatosur të cilët, duke përdorur armët e zjarrit shpesh apo tërë kohën, plaçkitën dhe dogjën shumë shtëpi. Dëshmitarët ishin të frikësuar për jetët e tyre. Shumë nga ata humbën tërë pasuritë. Shumica e dëshmitarëve ishin fqinjë dhe i përkisnin kryesisht vetëm dy (2) familjeve çka edhe sugjeron se ngjarjet pasuan me një komunikim intensiv në mes dëshmitarëve lidhur me vështrimet e tyre, idetë, hamendjet dhe përshtypjet e tyre. Dëshmitarët u morën në pyetje herën e parë nga KFOR-i disa muaj pas ngjarjeve. Gjatë viteve në vijim ata u morën në pyetje përsëri e përsëri, aspak për shkak të faktit se lënda është kthyer dy herë për rigjykim dhe si pasojë është gjykuar tri (3) herë pranë gjykatës së shkallës së parë. Nuk ka dyshim se pritej të ketë paqëndrueshmëri dhe mospërputhje të shumta kundër këtij formulimi të ngjarjeve të cilat, siç i ka theksuar Gjykata Supreme në vendimin e saj të mëparshëm, nuk i paraqesin automatikisht deklaratat si jo të besueshme, por kërkojnë një vlerësim veçanërisht të kujdesshëm nga gjykata me qëllim të vërtetimit të fajësisë së të akuzuarit.

¹ The date of his appeal “4 October 2008”, which can be found on the Serbian as well as the English version, is obviously a typo.



Përveç kësaj strategjia e mbrojtjes së të akuzuarit– komploti kundër tij pasi që dëshmitarët e njihnin atë shumë mirë – duhej të merrej parasysh, aq më tepër kur atë e kishin paraqitur edhe në TV si “kriminel serb i luftës” menjëherë pas prillit 1999.

b.

Një rishikim i kujdesshëm i aktgjykimit të ankimuar të shkallës së parë, megjithatë, zbulon se gjykata e shkallës së parë nuk kishte respektuar në një shkallë plotësisht të kënaqshme parimet e një shqyrtimi tërthor të dëshmimeve.

aa.

Gjykata e shkallës së parë pas marrjes përsëri në pyetje shumicën e dëshmitarëve të prokurorisë erdhi në përfundim se vetëm dëshmitë e dy dëshmitarëve ishin të besueshme: të Gani Bekës dhe Selman Avdiut.

Fakti se gjykata e shkallës së parë në fund u besoi vetëm këtyre dëshmitarëve, kurse dëshmitë e jo më pak se njëzet e tre (23) dëshmitarëve ishin kualifikuar si jo të besueshme apo të parëndësishme, do të ishte edhe një arsye më e fortë që dëshmitë e këtyre dy (2) dëshmitarëve të vlerësohen me një kujdes të veçantë me qëllim të sqarohet pse veçanërisht këta dy dëshmitarë kishin treguar të vërtetën.

Një vlerësim i tillë i kujdesshëm, megjithatë, nuk mund të gjendet në aktgjykimin e ankimuar. Si shembull të mungesës së analizës së thuktë të duhur duhet t'i referohemi vlerësimit të dëshmisë së dëshmitarit Gani Beka. Deklaratat e dhëna prej tij gjatë rrjedhës së procedurës penale² shfaqin shumë kundërthënie lidhur me të bëmat e pretenduara të të akuzuarit.

Për shembull, Gani Beka në deklaratën e tij dhënë më 18 shtator 1999 ai dëshmoi se dy burra të quajtur “Bozhur” dhe “Sholle” vunë zjarrin shtëpisë së Xhevat Zekës, kurse në dëshminë e dhënë më 10 qershor 2002 ai dëshmoi se i akuzuari ia kishte vënë zjarrin shtëpisë. Në deklaratën e tij dhënë më 25 qershor 2002 ai prapë fajësoi një njeri të quajtur “Bozhur” për plaçkitje dhe për djegien e shtëpisë së Xhevat Zekës; ai madje veçanërisht dëshmoi se ai nuk e kishte parë të akuzuarin duke plaçkitur shtëpinë e Zekës. Në deklaratën e tij të datës 17 shtator 2007 në anën tjetër ai prapë dëshmoi se ishte i akuzuari, tani së bashku me “Bozhurin” të cilët kishin djegur shtëpinë, kësaj here duke pretendohet pasi kishin qitur jashtë një grua të vjetër - Bahtie Zeka – një detaj që dëshmitari nuk e kishte përshkruar asnjëherë më parë .

Këto kundërthënie, që lidhen me identifikimin si dhe me pjesëmarrjen specifike të të akuzuarit, do të kërkonte një justifikim të shëndoshë në mënyrë që të pranohet si e besueshme dëshmia e dëshmitarit Gani Beka. Ata po ashtu do të kishin kërkuar një vlerësim të përgjithshëm bashkë me dëshminë e të gjithë dëshmitarëve okularë me qëllim

² Në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë (versioni në anglisht) të përshkruar në faqet 48 deri 51

që të vërtetohet se cili prej shumë versioneve në dëshminë e Gani Bekës do të caktohej si e besueshme.

Një vlerësim i tillë, megjithatë, nuk pasqyrohet në aktgjykimin e shkallës së parë. Në vend të kësaj thuhet se “dëshmia e tij më 17 shtator 2007 vërtetoi dëshmitë e tij të lartpërmendura, që do të thotë se të akuzuarit Vuckovic dhe Bozhur ishin personat të cilët kishin hyrë në shtëpinë e Xhevat Zekës; kishin qitur jashtë Bahtie Zekën nga shtëpia; ishin kthyer dhe i kishin vënë zjarrin shtëpisë; ai nuk mundi të veçojë se kush e kishte djegur shtëpinë e Xhevat Zekës por Mosa³ dhe Bozhuri hynë në shtëpi bashkë dhe kur ata u larguan, shtëpia tanimë ishte në flakë”⁴.


Kundërthëniet e qarta në dëshminë e Gani Bekës, të përshkruara më lart, as nuk janë të përmendura në vlerësimin e dëshmisë së tij. Përkundrazi aktgjykimi thotë se “të gjitha dëshmitë e tij janë të qëndrueshme në tërë faktet materiale”⁵, dhe si përfundim aktgjykimi vazhdon se “për shkak të gjitha arsyeve më lart Gjykata e konstaton Gani Bekën si dëshmitar të besueshëm dhe u jep besueshmëri të gjitha dëshmime të tij.”⁶.

Ky konstatim nuk mund të pranohet, sepse logjika nuk lejon të merren të gjitha deklaratat e këtij dëshmitari përfshirë kundërthëniet e tyre drastike si të besueshme.

Siç përmendet më lart, mënyra se si janë vlerësuar deklaratat e dëshmitarit Gani Beka nga gjykata e shkallës së parë është vetëm një shembull në përgjithësi i nivelit të pakënaqshëm të shqyrtimit me të cilin janë vlerësuar dëshmitë. Kolegji i Gjykatës Supreme nuk është në ndjekje të shterimit të tërë kundërthënieve, mospërputhjeve dhe paqëndrueshmërisë të këtij dhe dëshmitarëve tjerë, sepse aspektet tjera të udhëzimeve të dhëna nga Gjykata Supreme në vendimin e vet të mëparshëm nuk janë respektuar plotësisht as në aktgjykimin e shkallës së parë. Në veçanti nuk mund të gjendet një vlerësim tërësor i dëshmisë së dëshmitarit Gani Beka dhe Selman Avdiu duke marrë parasysh mospërputhjet dhe paqëndrueshmërinë në mes deklaratave të këtyre dy dëshmitarëve, e lere më vlerësimin e përgjithshëm të duhur e të gjitha deklaratave të dëshmitarëve së bashku.

Si rezultat kolegji i Gjykatës Supreme konstaton se vlerësimi i dëshmitarëve të prokurorisë nuk i është përmbajtur udhëzimeve të dhëna nga Gjykata Supreme e Kosovës.

bb.



³ Nofka e të akuzuarit

⁴ Shih faqe 52 paragrafi 3 (versioni në gjuhën angleze)

⁵ Shih faqe 52 paragrafi 6 (versioni në gjuhën angleze)

⁶ Shih faqe 53 paragrafi 12 (versioni në gjuhën angleze)

Veç kësaj, alibia e ngritur nga i akuzuari nuk është vlerësuar me kohë nga gjykata e shkallës së parë.

I akuzuari pohoi se për shkak të një aksidenti trafiku në dhjetor 1970 ai vuante nga një lëndim i përhershëm i këmbës së tij të majtë që i pamundësoi atij të ecte që atëherë pa ndihmën e patericave dhe si pasojë kjo e bën fizikisht të pamundur që ai të ketë kryer krimet e pretenduara.

Lidhur me këtë deklaratë gjykata e shkallës së parë dëgjoi dy (2) ekspertë mjekësorë, Dr. Aleksander Vasic dhe Dr. Bedri Bakalli, dhe përveç kësaj trembëdhjetë (13) dëshmitarët, Hysni Strana, Dr. Drita Fazliu, Dr. Agim Peci, Dragisa Ristic, Vladimir Ilic, Predrag Milanovic, Jovica Denovic, Stavro Velimirovic, Zurica Radovic, Viselav Mihajlovic, Milica Mihajlovic, Xhevat Beqiraj dhe Drasko Knezevic.

Të dy ekspertët mjekësorë paraqitën, si rezultat të vlerësimeve të tyre, konstatime të ngjashme – megjithatë me disa variacione të caktuar sa i përket disa detajeve – të cilat mund të përmbliidhen në atë mënyrë që i akuzuari ka vuajtur nga lëndimi i këmbës që prej aksidentit me veturë. Ky lëndim i këmbës i pamundësoi atij të ecte pa paterica (Dr. Vasic) apo të paktën që të ecte më shumë se dyqind (200) apo treqind (300) metra pa paterica (Dr. Bakalli).


Këto konstatime në një shkallë të lartë ishin vërtetuar nga shumica e dëshmitarëve që dëshmuuan se i akuzuari kishte nevojë disi për – sa i përket detajeve kishte disa mospërputhje – ndihmën e patericave, së paku gjatë ecjes në distanca të mëdha apo gjatë lëvizjes në terren të vështirë siç janë shkallët. Vetëm dy (2) dëshmitarë, Dr. Drita Fazliu dhe Dr. Agim Peci, dëshmuuan se nuk e kishin parë kurrë të akuzuarin të përdorte paterica.

Kjo situatë dëshmuese do të kërkonte një qasje dy-hapësh për të vërtetuar përtej çdo dyshimi të bazuar fajësinë e të akuzuarit: në hapin e parë do të ishte e domosdoshme të bëhej shqyrtimi i të gjitha deklaratave të dëshmitarëve si dhe i konstatimeve të këtyre dy (2) ekspertëve me qëllim të paraqitjes së një fotografie sa më të saktë të gjendjes fizike të të akuzuarit në kohën kritike, duke vazhduar me hapin e dytë nëse ishte ende e mundur të mbështetej besueshmëria e dëshmitarëve Gani Beka dhe Selman Avdiu duke marrë parasysh konstatimet lidhur me gjendjen shëndetësore të të akuzuarit.

Kolegji i Gjykatës Supreme konstaton se aktgjykimi i shkallës së parë nuk mund të merret si e kënaqshme në vlerësimin e këtyre çështjeve të alibisë.

Aktgjykimi i shkallës së parë nën titullin “konstatimet”⁷ është i kufizuar sa i përket kryesisht deklaratave të dëshmitarëve Dr. Drita Fazliu dhe Dr. Agim Peci, veç kësaj përmend vetëm dëshmitarët Dragisa Ristic, Vladimir Ilic dhe Predrag Milanovic. Dëshmia përkatëse e së paku shtatë (7) dëshmitarëve shfajësues madje as nuk përmendet në këtë kontekst, e lere më të merret parasysh.

⁷ Faqe 83 e versionit në gjuhën angleze



Aktgjykimi i shkallës së parë gjithashtu konsideron se deklaratat e dëshmitarëve që u morën parasysh “janë në pajtim me konstatimet dhe dëshminë e ekspertit Dr. Bakalli”⁸, konstatimet e të cilit në paragrafin vijues janë anuluar disi nga kolegji i shkallës së parë duke u bazuar në vështrimet e veta gjatë shqyrtimit gjyqësor se “gjatë dy (2) shqyrtimeve të fundit (i akuzuari) befas u ngrit nga ulësja e tij dhe tentoi ti afrohet Gjyqit ti tregojë këmbën dhe shputën”⁹.

Duke u bazuar në këtë vlerësim gjykata e shkallës së parë arriti “mendimin e peshuar se duke pasur parasysh gjendjen shëndetësore dhe paaftësinë fizike të Vuckovicit në vitin 1999, paaftësia e tij fizike ishte në pajtueshmëri me kryerjen e tij të krimeve të ngarkuara kundër tij”¹⁰.

Për shkak të shumë arsyeve kjo nuk mund të shihet si vërtetim i duhur i fakteve.

Si çështje orientimi gjykata e shkallës së parë ishte e obliguar ti marrë parasysh të gjitha deklaratat e dëshmitarëve, e jo vetëm deklaratat e dëshmitarëve të zgjedhur. Thjesht, të injorohen deklaratat e dëshmitarëve që dëshmuan në dobi të të akuzuarit është një shkelje e patolerueshme e të drejtave.

Së dyti, deklaratat e disa dëshmitarëve të përdorura nga gjykata e shkallës së parë nuk janë fare në përputhje. Dëshmitarët Drita Fazliu dhe Agim Peci deklaruan se kurrë nuk kishin parë të akuzuarin me paterica, kurse dëshmitari Dragisa Ristic deklaroi se i akuzuari ka përdorur paterica gjatë ngjites nëpër shkallë dhe gjatë vështrësive në ecje. Dëshmitari Vadimir Ilic po ashtu deklaroi se i akuzuari çalonte dhe përdorte paterica. Njësoj dëshmitari Predrag Milanovic deklaroi se i akuzuari çalonte dhe ka mundur të ecte vetëm disa hapa pa paterica. Megjithatë, në aktgjykimin e shkallës së parë nuk mund të gjendet një vlerësim i këtyre deklaratave kundërtënëse dhe një arsyetim se cilat fakte gjykata i vërtetoi duke u bazuar në dëshmitë e tyre.


Së treti, marrë parasysh mospërputhjet në mes të deklaratave të dëshmitarëve Fazliu dhe Peci në njërën anë dhe dëshmitarëve Ristic, Ilic dhe Milanovic në anën tjetër përfundimi i kolegjit të shkallës së parë se dëshmia e të gjithë këtyre dëshmitarëve është “në përputhje me konstatimet dhe dëshminë e Dr. Bakallit”, nuk është e kuptueshme.

Së katërti, gjykata e shkallës së parë në fund edhe anuloi konstatimet e Dr. Bakallit si dhe të Dr. Vasicit – se i akuzuari nuk ishte në gjendje që së paku të ecte më shumë se disa qindra metra pa ndihmën e patericave- duke zëvendësuar konstatimet e ekspertëve me “ekspertizën” e vet mjekësore të fituar gjatë vështrimit se i akuzuari mund të lëvizte në gjykatore pa paterica. Me këtë gjykata e shkallës së parë tejkaloi sferën e kompetencave të veta profesionale dhe njëkohësisht gjykoi gabimisht dallimin në mes të lëvizjes për disa metra në gjykatore dhe kryerjes së veprave siç përshkruhen nga dëshmitarët okularë të veprave penale të pretenduara, do të thotë ecjes poshtë kodrës në tokë jo të rrafshët, duke bartur një pushkë automatike të rëndë, duke hulumtuar fshatin e

⁸ Faqe 83 e versionit në gjuhën angleze

⁹ Faqe 84 e versionit në gjuhën angleze

¹⁰ Shih fusnotën 8



duke shtënë shpesh, nëse jo vazhdimisht, me armë, duke hyrë nëpër shtëpi, duke qitur jashtë gjëra të runda etj., të gjitha këto duke marrë orë të tëra pa përdorur asnjë lloj të ndihmesave për ecje.

Si rezultat kolegji i Gjykatës Supreme konstaton se aktgjykimi i shkallës së parë po ashtu ka dështuar të vërtetojë drejt dhe plotësisht faktet përkitazi me alibinë e ngritur nga i akuzuari. Mbi të gjitha, as në aktgjykimin e shkallës së parë nuk mund të gjendet një vlerësim i përgjithshëm tërësor dhe i kënaqshëm i të gjitha dëshmive fajësuese dhe shfajësuese së bashku, siç është kërkuar prej Gjykatës Supreme në vendimin e vet të mëparshëm.

Mund të jetë objekt kundërshtimi nëse secili prej këtyre lëshimeve lidhur me vlerësimin e dëshmive, shikuar individualisht, do të mjaftonte të kundërshtojë vërtetimi i duhur dhe i plotë i gjendjes faktike. Megjithatë, nuk ka kundërshtim se të metat në përgjithësi dhe në veçanti mënyra se si është hedhë poshtë alibia e të akuzuarit nga gjykata e shkallës së parë e bëjnë të pamundur të mbështeten faktet si të vërtetuara drejt dhe plotësisht.

Prandaj, ankesat duhej të pranoheshin në përputhje me Nenin 366 Paragrafin 1 të LPP-së.

3.

Si pasojë në përputhje me Nenin 385 Paragrafin 1 të LPP-së aktgjykimi duhet të priset dhe lënda të kthehet prapa në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim. Formulimi i ligjit procedural qartazi nuk siguron ndonjë mjet tjetër. Në veçanti nuk lejon të ndryshohet aktgjykimi i shkallës së parë.

Megjithatë, kjo dispozitë procedurale duhet të interpretohet nga pikëpamja e Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut (KEDNj), veçanërisht Neni 6 i kësaj Konvente e cila thotë se çdo i pandehur gëzon të drejtën e procedurës penale “brenda një kohe të arsyeshme”.

Në këtë lëndë një rigjykim tjetër do të rezultonte me shkeljen e kësaj të drejte të të akuzuarit dhe andaj nuk do të ishte e justifikueshme.

I akuzuari ishte gjykuar hiq më pak se tri (3) herë në nivel të shkallës së parë dhe hiq më pak se tri (3) herë në Gjykatën Supreme të Kosovës. Të gjitha tri (3) aktgjykimet e shkallës së parë dehej të prisheshin sepse gjykata e shkallës së parë nuk vërtetoi drejt faktet. Procedura penale kundër të akuzuarit filloi më 1999, hiq më pak se para dhjetë (10) viteve. Pavarësisht nga fakti se gjatë kësaj procedure penale deri tani ishin prodhuar një numër i madh i dëshmive kundërshtuese dhe kundërtënëse, një situatë që mund të keqësohet gjatë një gjykimi të katërt të shkallës së parë, periudha e “afatit të arsyeshëm kohor” qartazi ka kaluar. Numri i rigjykimeve në kombinim me kalimin e kohës 10 vjeçare shënon një vonesë të patolerueshme të procedurës dhe si pasojë kërkon që

procedura penale kundër të akuzuarit të përfundohet në mënyrë që të mbrohen të Drejtat e tij themelore të Njeriut.

Prandaj Gjykata Supreme, me qëllim të respektimit të standardeve ndërkombëtarisht të pranuar të të Drejtave të Njeriut dhe mbështetjes së jurisprudencës së saj të mëparshme¹¹, është përbajtur që të kthejë prapa lëndën për një rigjykim tjetër. Në vend të kësaj, Gjykata Supreme, duke zbatuar parimin *in dubio pro reo*, ndryshon aktgjykimin e shkallës së parë në tërësi dhe liron të akuzuarin nga të gjitha akuzat.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ap.-Kž. Nr. 1/2009

Kryetar i Kolegjit

Norbert Koster

Anëtar i Kolegjit

Guy Van Craen

Anëtar i Kolegjit


Emilio Gatti

Anëtar i Kolegjit

Ferdinando Buatier de Mongeot

Angela Kaptein

¹¹ Shih, për shembull, aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës në lëndën kundër Skender Halilaj *et al.*, të datës 26 qershor 2008, AP-Kz 393/2006.



Republika e Kosovës  Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik
[Signature]